REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA MALIQ

KËSHILLI I BASHKISË

Datë 27.03.2026 Prot.53 (pesëdhejtëetre)

Protokoll nr. 53

I mbajtur sot më datë 27.03.2026, në mbledhjen e radhës të Këshillit Bashkiak Maliq, në sallën e mbledhjeve të këshillit të bashkisë, ora 10:00.

Rend Dite:

1.Hapja e mbledhjes (korumi, miratimi i rendit të ditës, vendimet e mbledhjes së kaluar);
2.Deklarimi i konfliktit të interesit nga këshilltarët, për vendimmarrjen lidhur me çështjet e rendit të ditës.
3.Miratimi i procesverbalit të mbledhjeve të kaluara (10.02.2026, 27.02.2026)
4.P-V "Për miratimin e Ndihmës Ekonomike deri në masën 6% të fondit për muajin shkurt 2026";
5.P-V "Për dhënie ndihme financiare për familje në nevojë"
6.P-V "Për disa shtesa dhe ndryshime në VKB-në nr.2 datë, 08.01.2026 "*Për miratimin e numrit të punonjësve, nivelin e pagave të adminstratës së Bashkisë Maliq dhe strukturave të tjera për vitin 2026";* i ndryshuar.
7.P-V "Për "Miratimin e tavaneve përgatitore të shpenzimeve të programit buxhetor afatmesëm 2027-2029 në nivel programi";
8.P-V "Për miratimin e planit të masave për parandalimin dhe menaxhimin e zjarreve në fondin pyjor/kullosor dhe krijimin, organizimin dhe funksionimin e shërbimit vullnetar të bashkisë Maliq";
9.P-V "Për miratimin e listës së kullotave dhe kositjeve për sezonin 2026 dhe miratimin e kontratës tip të dhënies me qira për kullotje'';
10.Diskutime të tjera.

Këshilltarë të pranishëm në sallë:

Ornildi Demollari;Idlir Limllari; Fevri Sherifi; Pranvera Begolli; Enida Avdolli; Danjela Ibrahim; Gentiana Drabo;Floreta Zaçe; Aramando Dautllari; Marinathi Avrami; Klea Baçi;Dritan Çami;Selami Muço; Xhuana Hoxhallari; Rovena Terolli; Eriseld Jonusllari; Faslli Zholi; Andonaq Risto; 18 (tetëmbëdhjetë) këshilltarë.

Mungesa: Petrit Kupe; Plator Çollaku; Kristina Malelli; Albina Xhejo; Eglantina Balli; Marjeta Xhelollari; Lulëzim Hoxhaj; Almir Elezi; Yllson Ibrahimllari; Server Xhuti; Neresida Shindo; Dalina Krekas; Ilia Xhuti; 13 (trembëdhjetë).

Të pranishëm nga Administrata: Kryetari i Bashkisë;z.Gëzim Topçiu; Drejtore e Shërbimit Social; znj.Ermanda Petriti; Përgjegjës i Sektorit të Pyje-Kullota; Klarsen Brako; Përgjegjëse Sektori Financë, Kontabiltet dhe Buxheti; znj.Matilda Shaholli;

Ornildi Demollari: Mirëdita të gjithëve të nderuar kolegë, t'ë ndërruar pjesëmarrës. Na erdhi edhe kryetari i bashkisë. Të nderuar kolegë, të ndërruar pjesëmarrës, i nderuar kryetar. Po fillojmë këtë mbledhje të radhës. Këshilli i Bashkisë Maliqit, sikurse edhe kemi njoftuar disa ditë më parë, edhe në respekt të afatit të për njoftimin dhe me material. Besoj se jeni pajisur disa ditë përpara, gjithashtu kështu që bëjmë një verifikim të korumit dhe vijojmë pastaj me rendin e ditës. Nga sa po shoh, janë gjashtëmbëdhjetë shtatëmbjetë këshilltarë në sallë, kështu që mund të vijojmë, sepse rendi i ditës miratohet. Dhe ju ftoj të sepse korumi realizohet dhe ju ftoj të miratojmë. Rendin e ditës, kush është dakord me rendin e ditës? 17 vota pro.
Kundër? Nuk ka.
Abstenim? Nuk ka.Miratohet, faleminderit, por do të kërkoja mirëkuptimin tuaj për të shtuar edhe një material, më falni, që është një P-V fshati Lemionot Njësia administratë Pirg, që besoj se ju ka ardhur me vonesë të më korrigjojë sekretari. Ka shkuar me vonesë, kështu që do desha ta shtonim edhe këtë në rendin e tij, Ju lutem, a jemi dakord duke shtuar këtë kundër? Nuk ka abstenim, miratohet. Vijojmë atëherë. Më lejoni t'ju njoh me projektvendimet e mbledhjes së kaluar. Janë gjithsej nëntë projektvëndime me karakter normativ, të cilat, pasi kanë marrë dakordësinë e institucionit të prefekturës, janë kthyer në vendime. Shtatë të tjera, me karakter kolektiv, janë kthyer në vendime tashmë, ndërkohë ju ftoj të miratojnë protokollin e mbledhjes së kaluar të datës tetëmbëdhjetë mars. Kush është dakord me protokollin? Kam tetëmbëdhjetë mars, protokolli i mbledhjes dhjeti i dyti më fal. Kush është dakord 17 vota pro.
Kundër? Nuk ka.
Abstenim? Nuk ka. Miratohet edhe protokolli i mbledhjes së datës njëzet e shtatë të dytë. Kush është dakord? 17 vota pro.
Kundër? Nuk ka.
Abstenim, miratohet faleminderit. Vijojmë me rendin e ditës, projektvendim për miratimin e. Ndihmës ekonomike deri në masën gjashtë për qind të fondit për muajin shkurt dy mijë e njëzet e gjasë. Ka ndonjë pyetje këtu, komisioni?

Faslli Zholi:Përshëndetje të nderuar kolegë këshilltarë, pështëndej kryetari i kështetit, parshëndetje kryetar i bashkisë, komisioni i ndihmave ekonomike dhe familjet në nevojë u mblodhën ditën e djeshme në orën dymbëdhjetë dhe konkluduan me disa pyetje të cilat unë mund t'i bëj edhe këtu publike përsa i përket ndihmohave pa e hyrë në detajet dhe kriteret, po shikoj vetë edhe fakt dhe ekonomia e njerëzve. Sa vjen dhe varfërohet, mendova që në bazë të ligjet apo të rregullat të shikohej një mundësi që ai gjashtë për qindëshi e di që është dhe e

morrëm një sqarim dhe nga ekzekutivi të shikohet një rritje e tyre, sepse ata qytetarë janë sipas listave dhe ne që i miratojmë janë me të vërtetë familje që kanë nevojë për këtë sipas dokumtacionit që kanë paraqitur, të shikohet një mundësi jashtë shtesë, siç bëhen edhe në pagat e tjera, sipas rregullave. Përsa i përket edhe këtyre ndihmave që të mos bëjnë. Dy, tre familjet në nevojë, që të mos u bezdis. I pamë t'i tre me kujdes ato familjet e para. Që unë kisha rezerva ishte familja në Shkozë, pa e bërë edhe emrin e tij, ishte blegtoria e dëmtuar që ne kemi parë në televizor. Edhe për atë bëheshe fjalë që sqaruam. Pashë aty që është vetëm thjesht ka këtë nevojë, ka qënë mbetet kështu. Unë mendoj sepse që të japësh një para dhe le ta fitojë, se unë jam për ata bujqësinë dhe blegtorinë ta marrin në këmbim. Po duhet të ketë një në bazë të relacionit që bëhet për të kërkuar këtë shpërblim, të jetë një proces verbal, pse jo, dhe nga veterinaria që kanë ngordhur këto bagëti. Ka foto, ka gjëra, janë groposur, sepse mos i hyj me dhanë shëndetësore. A janë groposur? A janë kontrolluar? Dhe kush ka qenë komisioni i vlerësimit? Duhet të jetë ky procevrbali në bashki i dokumentave përtasë, të cilën ta bindim edhe ne si këshilltarë, po dhe komunitetin, që kjo qëndron dhe është kështu. Vajza më tha që e kemi si dokument, po për mund të ma vinte edhe mua. Unë nuk e kërkova, po që dokumentet mire është që e kshilli. Duhet ta njohë këtë histori, që ka qenë një komision me proceverbal të saktë, kush e ka bërë, dhe ta fitojë ai. Unë e jap okej që ta marrin ndihmën e qytetarit, sepse ne për këto kemi ardhur këtu, që ti ndihmojmë ata që kanë nevojë dhe në fatkeqësi të tilla. Kaq isha për këto dy pika ndaj komisionit të ekonomisë dhe ndihmave sociale. Faleminderit që më dëgjove.

Ornildi Demollari: Falëminderit, kryetar, a do fjalët?

Kryetari i Bashkisë;z.Gëzim Topçiu:Për të parën, unë mendoj që Drejtoria e Shërbimit Social duhet të, rast pas rasti, në varësi edhe të problematikave dhe t'kërkesave, duhet shikojë. Mesa di unë, edhe në buxhet ne kemi fond të parashikuar për këtë qëllim. Kurse në lidhje me rastin e dëmtimit të blegtorisë në fshatin Shkozë. Unë do të sqaroj që ne kemi një informacion të plotë për të gjithë çka ka ndodhur me procesverbale nga Drejtoria Rajonale e Bujqësisë, nga Agjensia. e veterinarisë, e cila edhe ajo ka kërkuar dëmshpërblim për rastin në fjalë nga Ministria e përkatës, Ministria e Bujqësisë dhe e Zhvillimit Rural, edhe me sa kemi informacion. Se nuk është rasti i vetëm në Shqipëri, kjo sëmundje preku një sërë fermerësh në të gjithë Shqipërinë dhe po shikohet mundësia të kompensohet nga buxheti i shtetit, por duke qenë që ë Rasti ishte vërtetë fatkeq për një familje, e cila i dëmtohet komplet blegtoria me rreth dyqind krerë, dyqinte e shtatë. Për të qenë i saktë, ne mendojmë që bashkia, këshilli bashkiak, të jetë mbështetës të paktën deri diku që kjo familje të fillojë ta rimarrë veten. Ndaj, edhe në qoftë se duhet që ne t'ju paraqesim një dokumentacion, po unë besoj duhet të ishte bashkëngjitur nj pjesë e dokumentacionit. Pasi është një dosje goxha voluminoze, patjetër. Sektori i bujqësisë që ne kemi, e kemi dosjen të plotësuar. Mund t'ia vëmë në dispozicion, bile t'i bashkëngjitim disa dokumenta bazë.Institucionit të prefekturës, e cila do të kalojë edhe vendimarrja e këshillit. Shumë faleminderit.

Ornildi Demollari: Faleminderi, kryetar. Kjo ishte për pikën pesë në fakt.Dakord, drejtoresha për pikën 4 kishe diçka.

Drejtore e Shërbimit Social; znj.Ermanda Petriti:Përsa i përket ndihmës ekonomike nga fonde gjashtë pëër qind, ajo është e përzcaktuar me VKM masa e përfitimit për secilën familje. Kështu që ne jemi mbështejtur. Po në ato, në to VKM-në, gjithashtu janë edhe të dhëna të cilat dalin nga sistemi i ndihmës ekonomike dhe nuk ndërhyhet për llogaritje nga ana e administratorëve shoqërorë. Mirë do ishte që kjo masë të ishte më e lartë. Po kjo duhet parë pastaj nga.Vendimet e qeverisë, faleminderit.

Faslli Zholi: Unë do të isha këtu, Ermanda, se e konsumon dhe di edhe kryetari është këtu. VKM-në, e kuptoj që ju ndaj ligjit nuk duhet të dalë edhe unë. Nuk janë pra të dalë nga ne, por VKM-ja rrit dhe rrogat, dhe unë shikoj që të marr njëzet e pesë apo një qytetar në familje janë pak. Ne kemi shumë nevojë, po të paktën kur ngrihen rrogët, edhe ata të mos jenë. Janë të veçuar, po keni dhe ata në lartësinë që duhet. Këtë e them që edhe VKM-ja, meqë më do prisni dhe kërkoheni të vini VVK-në, që ta përmirësojë këtë. Sepse e shikojmë qe nafta po shkon dy mijë e dyqind lekë. Të tjera gjëra ne i dimë, jemi koshientë të gjithë për këta qytetarë. Faleminderit.

Ornildi Demollari: Kemi gjë tjetër tek pika katër, ju lutem. E kalojmë votim atëherë pikën katër? Mbledhjes i bashkohet dhe z.Eriseld Jonullari, largohet nga mbledhja znj.Floreta Zaçe. Numri i këshilltareve të pranishëm në sallë mbeten 17 këshilltarë. Kush është dakord? 17 vota pro.
Kundër? Nuk ka.
Abstenim? Nuk ka. miratohet faleminderit. Dhe kalojmë tek pika pesë e rendit të ditës, që ë Projekt vendim për dhënien ndihmë financiare pëër familjet në nevojë është ajo që preku pak kryetarin në shpjegim. Nuk e di komisioni i financës, po komisionin e finances.

Pranvera Begolli: Aktualisht, ne nuk kemi ndonjë problem për ndihmën e atyre, por unë kam diçka tjetër përtështuar. I pranishëm në sallë është një djalë tetëmbëdhjetë vjeç, që ka bërë në njo operacion me tumor në tru. E mira është ta ndimonim, ta futnim që sot në rendin e ditës, ai dokumentat i ka sjellë te zyra e ndihmës ekonomike për t'i dhënë një vlerë, një vlerë 100.000 lekë. Ky është propozimi që bëj unë, drejtoresha mund të flasim më mirë me dokumentat që janë paraqitur. Fëmija është aty me të ëmën. Ju faleminderit.

Kryetari i Bashkisë;z.Gëzim Topçiu: Po unë mendoj që këto raste që mos i ndodhin asnjeriu, lusin të mos kemi raste të tilla, duhet të rekorduar paraprakisht edhe me Drejtorinë e Shërbimit Social. Dhe mos e lëmë në momentin e fundit. Megjithëatë të shikojnë dokumentat, nuk jam kundër, jam në parim. Jam dakord, ndosahta Ermanda, se duhet parë ana financiare, diagnoza, nevojat, që mos dukemi sikur. E bëjmë për të kaluar radhën, apo nuk i shërbejmë sa duhet këtij rasti. Gjithashtu, në parim, unë do isha dakord që këshilli ta trajtojë. Ermanda mund të thotë diçka më shumë.

Faslli Zholi: Ermanda është ajo rasti që diskutuam dije, që tha nuk ka paraqitur në kohën e duhur dokumentat. Atëherë, unë jam me fjalën e kryetarit. Në parim, ai djali ëtshë i ri dhe jetë të

gjatë të ketë. Çfarë mund t'i bëjmë? Por kjo është që duhet dokumentuar, se na bëhet si e rrugës. Kjo që mbaj seriozitetin e duhur çdo shpërblim dhe çdo faleminderit.

Drejtore e Shërbimit Social; znj.Ermanda Petriti: Faktikisht, njësi administrative ka dorëzuar dokumentacionin përkatës pë të dy rastet. të që ne kishim për të trajtuar sot, megjithatë shpresojmë që herës tjetër ti kemi më në kohë dokumentacionit.

Ornildi Demollari: E kalojmë votim duke shtuar edhe rastin e djalit në vlerën njëqind mijë lekë. Dakord. e kalojm votim, duke e shtruar edhe rastën e djallit. Kush është dakord? 17 vota pro. Kundër? Nuk ka.
Abstenim? Nuk Ka. Miratohet faleminderit. Dhe kalojmë tek pika gjashtë e rendit të ditës, që është projektvendim për disa shtesa. Dhe ndryshime në vendimin e Këshillit të Bashkisë me numër dy, datë tetë i pari, dy mijë e njëzetë e gjashtë, për miratimin e numrit të punonjësve, nivelin e pagave të administratës së bashkisë dhe strukturave tjera për vitin 2026 I ndryshuar.

Pranvera Begolli: Komisioni i financës ndodh në prani të kryetarit të bashkisë, i cili do të japë sqarimet e duhura.Ne mendojmë që ky P-V, duhet të miratohet, kryetari do bëjë të gjitha sqarimet e duhura, besoj se gjithë anëtarët e Këshillit Bashkiak janë njohur me këtë projektvendim. Në qoftë se ndonjëri ka ndajnë diçka, mund ta thotë.

Ornildi Demollari: Kryetar, të lutem.

Kryetari i Bashkisë;z.Gëzim Topçiu:Bëhet fjalë për vën në rivendjen në punë të Pallatit të Kulturës Maliq, Qendrës Kulturore Komunitare. Ne e kemi parashikuar në buxhet që në fillim të vitit si fond. Nuk kërkojmë shtesë fondesh brenda buxherit, e kem fondin. Duam që kjo qendër të jetë një qendrë sa më funksionale dhe të shpresojmë që ajo synonim të fillonte më 1 prill. Po me sa duket, do të fillojmë me 1 maj me kapacitet të plotë. Duam që aty të funksionojnë kurset e ndryshme, të cilat do iu shërbejnë të gjithë qytetarëve të Bashkisë së Maliqit për mësimin e veglave muzikore, të pikturës. Të grupit të valleve, mësimit t'gjuhës angleze, dhe ne kemi bërë një riformatim edhe brenda strukturave tona, po janë të domosdoshme disa, e themi, instruktorë, të cilët bashkia nuk mund t'i mbulojë t'gjithë. Mësim violinë e mësim piano. Domethënë, ka disa pozicione apo disa eksperienca që ne i kemi marrë edhe nga qendra të tjera që ngjasojnë me atë çfarë ne duhet të arrijmë këtu, përjashtuar koroegrafi që mend mund të jetë edhe part-time, pasi për momentin jemi të bllokuar dhe ndoshta do ta shikojmë në këtë linjë. Projektvendimi brenda përfshin edhe personel mësimor të sistemit. parashkollor, i cili me vendim qeverie i bëhet një shtesë pagë në vlerë 2.5%, për efekt të koeficientit të indeksimit të pagave të inflacionit dhe totalin e përditshëm nuk kërkojmë as shtesë fondesh as tjera, por vetëm një riformatim të Drejtorisë së Kulturës që ne kemi të ngritur dhe plotësimi i tyre me fondet e miratuara nga Këshilli i Bashkisë në fund të vitit 2025. Si dhe plotësimin e personelit të parashkollor apo sanitar në arsimin parashkollar, i cili janë fonde të dedikuara nga Ministria përkatëse, nuk janë fondet tona. Të cilat mbulohen prej tyre, por ne e kemi detyruar ta kalojmë në këshillë, edhe si pagë, por dhe si fond për plotësimin e tyre.

Pranvera Begolli: Dhe diçka tjetër aktualisht, kryetari mund ta shpjegojë mirë. Kemi dhe një shtesë. që do të jetë bërë tek pjesa e arsimit, ku do t'vendoset një administrator që është vendosur tek projektvendimi pesë. Por njkohësisht do t'shtojmë dhe nj'koordinator.

Kryetari i Bashkisë;z.Gëzim Topçiu: Problemi i arsimit, ne kemi patur një kërkesë shumë të madhe nga drejtuesit e shkollave, të cilat kanë një ngërç midis funksionimit të drejtorisë së shërbimeve, edhe vetë shkollave dhe ata, siç është praktikë pothuajse në të gjitha bashkitë e tjera, e kemi bashkuar në buxhet një administrator. Por koordinimi i veprimeve në terren bashkë me ajo dilte e domosdoshme. Dhe këtë propozim ja u kemi risjellë për ta përfshirë në këtë projektvendim, që shkollat të kenë një administrator më vete. Për të menaxhuar çdo gjë që ndodh në të gjitha objektet shkallore, që nga pas stërtia që nga detergjentët, që ngrohja, që nga gjithë problematikat që kanë shkollat. Dhe pastaj ai i rakordon me të gjitha drejtoritë tona për ta plotësuar apo përt'i ndjekur të gjith shqetësimet, pasi kemi hasur vërtetë vështirës. Ku një përgjegjës ndjek edhe kanalet, edhe rrugët, edhe trotuaret. Po mendojmë që kjo të jetë pak më e precizuar dhe shkollat marrin atë. Ka qenë propozimi i vetë drejtuesve të shkollave dhe ne e kemi marrë në konsideratë kur kemi bërë dhe dëgjesat publike dhe ndaj po ia prezantojmë sot.

Faslli Zholi: Te pika gjashtë. Po i dëgjoj edhe kryetar, edhe unë i pashë me atë syrin tim. Mendoi kryetari që duhet administruar më mire lekët. Këtu e kam parasysh se po më duket si një fryrje, e pashë sanitarë, sanitar aty, dy sanitar, mbase janë në tre, lulishtarë. A janë të ngarkuar pyetje që kam unë me punën dhe përkatësinë e duhur këta njerëz? Një lulishtar, për shembull, mund ta bëjë edhe ai sanitar, po e marr si pa e paragjykuar. Dhe dua që të ngarkohen gjërat me punë, edhe i kursej, po dhe rritem edhe ato që po flasim.

Kryetari i Bashkisë;z.Gëzim Topçiu: Tani dua të sqaroj që godina e Pallatit të Kulturës është një godinë goxha e madhe. Me shumë ambiente, kush e ka? Kush e ka parë, kush e kanë vizituar, ose që besoj do të ndodhë për të gjithë shumë shpejt. Aty kërkon edhe një standard tjetër në kuptimin tonë. Ne jemi duke mbyllur systemin e oborrit të jashtëm, i cili dhe ai do të ketë një sistem ujitës të programuar lulishte nga të katër anët. Dhe duam që ajo qendër, ndoshta mund të jetë qendra unike më e mirë që do të kemi ne si territor, nuk kemi në qytetin e Maliqit një qendër që të jetë multifunksionale. Me ujitje, me tapet bari, me stola, me ndriçime të tjera dhe minimalisht ajo kërkon një njeri adapt që të jetë aty dhe ta ndjekë në çdo, është e programuar. Por pavarësisht kësaj, ajo do që ai fond që është hedhur aty të mirëmenaxhohet dhe të mos degradojë. Nga ana tjetër, territori që ka ajo godinë. Me sallë vetë, unë po ju them, vetëm salla e koncerteve apo dy sallat që kemi një nga të tretin. Do një mbrojtje që mos degradojë, se të jemi të vetdijshëm. Aty do ulet e do rrijë çdo lloj njeriu, çdo lloj qytetari, pavarësisht shkollës, përparësis ndjesisë dhe kërkon një mirëmenaxhim që ai investim, i cili në totalin e përditshëm shkon në shumë të konsiderueshme, falë edhe mbështetjes së fondit shqiptar zhvillimit të mos shkatërrohet, por të mirëmenaxhohet në çdo hap. Ndaj, kemi parë të arsyeshme që territori dhe i gjithë ai ambient të mirë menaxhohen. Jam shumë dakord që ne duhet të jemi shumë të kujdesshëm në menaxhimin e fondeve. Të jemi edhe kërkues llogarie që vërtetë i vendosim, por të bëjmë punën edhe aty të ndritë çdo gjë, pasi i flasim për një godinë e cila është mrmer nga

fillimi në fund, edhe nuk do na shkonte ne që të mos e menaxhojmë edhe të prezantojmë një objekt kulturë, siç ajo e vërtetë e ka emrin. Prandaj, qëllimi është parë ndoshta. E kemi parë edhe një çik më shumë se ç'duhet, krahasimisht me objektet tjera. Kjo është e vërtetë.

Ildir Limllari:Përshëndetje, kryetar. Jam dakord me këto ndryshime, po kisha një si. Jo si vërejtje, po ky këngëtari këtu, sikur t'i ndryshojë emri. Këtij kënga ishte mësues muzike, se ai do punojë tetor këngetar atje. Të jetë mësues muzikë, se kështu këngëtar, i punësuar këngëtar sikur nuk tingëllojnë mirë tetë orë.

Kryetari i Bashkisë;z.Gëzim Topçiu: Shiko, ne në strukturën e pallatit të kulturës kemi dy kënga me nocionin. këngëtarë, pasi atë punë bëjnë, edhe ata duhet që të t'ë sjellin, se nuk marrim këngtar part-time, siç ne erdhim përpara. I paguani, por i kemi në funksion të plotë dhe nga dy po i shkojmë në tre. Që të kemi pasi, ajo çfarë ne synojmë është që aty nuk do ketë vetëm këngëtarë, aty të nesër do ketë teatër. Ka filluar që tani, ka filluar puna me shkollat e mesme, me shkollat nëntëvjeçare për grupe. për grupet e valleve, për grupe të piktorëve,për aktivitetet, për promovim librash, është një punë voluminoze. Unë shpresoj të arrijmë atë që ne kemi. Kemi në mendje, nuk është kaq e thjeshtë, ndaj edhe po mundohemi të kemi eksperiencë edhe nga qendra e fëmijëve në Korçë, nga teatri i Korçes. Mendojmë të kemi bashkëpunime me të, që aktivitete që ky teatër që bën në Korçë, t'i zhvillojë edhe në Maliq me Kolonjën, po ashtu që të ketë një zhhvillim kulturor, pasi jo, nuk i kemi. Kemi qejf, të kemi të gjitha. Kapacitetet vetë, po nuk është kaq e mundur, ndaj dhe duan të bëjmë një ndërthurje me të gjithë aktorët e kulturës në rajon, që ajo qendër të jetë të gumëzhi çdo ditë, të gumëzhi edhe të dielë, edhe shtunë më shumë, dhe të jetë të hënën pushim, ndoshta po të ketë funksion të plotë, ka mundësi edhe në orët e vona, që fëmijët tanë, fëmiët dhe të gjithë bashkisë, të mos vijnë kurse në Korçë, po të vijnë në kurse në Maliq. Kemi edhe pastaj do të shikojmë lehtësira fiskale, sa sa mund të paguhet një apo si do t'i si do ta organizojmë këtë punë, që ajo të jetë funksionale dhe në njëfarë mënyre t' i largojmë fëmijët apo të rinjtë nga lokalet, nga sallat ku ka tym e ku ka zhurmë, e t'i çojmë për të marrë një profesion të veçantë. Sa do të arrijmë, nuk e di. Ne e synojmë shumë shpejt, ne të kemi grupet zinxhir të valles Gorare nga kalamajt e vegjël. Fëmijët, po kalamaja më pëlqente ta them, e deri tek të rriturit, që të kemi dhe ne prezantimet tona serioze, jo vetëm në Maliq, jo edhe në qark, po të gjithë në rang kombëtar, po dhe jashtë, siç e kemi patur në fund të fundit. Ky është qëllimi, është një punë shumë e madhe, të shpresojmë që do të na dalë me me bereqet.

Ornildi Demollari: Le të shpresojmë që të t'na shkojë mirë. E kalojmë votim?
Kush është dakord?17 vota pro.
Kundër?Nuk ka
Abstenim?Nuk ka. Miratohet. Të faleminderit, kalojmë tek pika shtatë e rendit të ditës. Që është projektvendim për miratimin e tavanëve përgatitore të shpenzimeve të programit buxhetor afatmesëm dy mijë e njëzet e shtati dy mijë e nëntë në nivel programi, komisioni i finances?
Pranvera Begolli:Është një procedurë që ndiqet për çdo vit. Detyrimisht, listat janë vënë. Janë njohur të gjitha programet me radhë, pikat se ku do bëhet kryetari, bën sqarimin e duhur. Dhe

mendoj që këto janë tavanet pregatitore që natyrisht ne i kemi miratuar si çdo vit për periudhën 2027-2029. Në komision jemi dakord për miratim.

Kryetari i Bashkisë;z.Gëzim Topçiu:Është një procedurë ligjore rutinë, të cilën ne e kemi edhe detyrim ligjor, po edhe. dhe për ta prezantuar, pasi të gjitha vendimarrjet që marrim, që kanë të bëjnë me tavanet përditore buxhetore trevjeçare. Miratohen nga këshilli i bashkisë, siç është, dërgohen në Ministria e Financave. Ata japin okejn. Me plus apo me minus, me vërejtjet që ata mund të kenë që e kemi zbatuar vendimin e qeverisë mbi tavanet buxhetore, pasi ata japin një marsh rritjeje nga njëri vit tek tjetri. Dhe pastaj, kjo kalon në disa faza. Nuk ka efekte ekzekutive, pasi në çdo vit ne miratojmë buxhetin në këshillën e bashkisë. Por është një punë përgatitore që përgatitemi edhe për 2027 apo për periudhë trevjeçare, me ide sipas programeve buxhetore që janë të pasqyruara në tabelat që ju kemi pasqyrë, ju kemin prezantuar për t'i gjitha strukturat buxetore që ne kemi të jemi të miratuara nga Këshilli i Bashkisë.

Ornildi Demollari: Faleminderit. Kemi gjë tjetër për tavanet, ne kalojmë në votim.
Kush është dakord? 17 vota pro
Kundër? Nuk ka.
Abstenim Nuk ka. Me 17 vota pro dhe asnjë kundër miratohet, dhe të gjitha vendimet deri tani janë miratuar me shtatëmbëdhjetë pro dhe zero kundër. Miratohet edhe pika shtatë. Faleminderit. Dhe kalojmë tek pika tetë e rendit të ditës. Projekti vendim për miratimin e planit të masave për parandalimin dhe menaxhimin e zjarreve në Fondin Pyjor Kullësor dhe krijimin, organizimin dhe funksionimin e shërbimit vullnetar të Bashkisë Maliq, pika tetë. Kush e do fjalën? Ka ndonjë pyetje?

Selami Muço: Një si pyetja kisha. Në Bashkinë e Maliçit thuhet këtu janë gjashtë NJ.A. Konkretisht, dihen ato që janë, kurse Maliqi vetë si qytet, Fshat Maliqi, Kolaneci, Goça, Bicka, Gjyrasi, Ploishti. Ku futen këto? Ose aty ka sipërfaqe të madhe pyjesh, sidomos në Bickë.Këtu s'bëhet fjalë për gjashtësh, siç është njesi i mbahet fjalash. Po, si thamë të qartë, kryetar, edhe këtë organizim në këtyre gjashtë fshatëve.

Kryetari i Bashkisë;z.Gëzim Topçiu: Ndoshta s'e kanë numëruar mirë, sa sa do të jenë. Edhe Maliqi qendër është njësi më vete, pavarësisht se s'ka administrator. Dakord, dakord, po ka pyje ti i dhembin pyjet e për fshatin e tij, e Gjyrasit. Jo, janë tre fshata që janë me pyjet. Ke shumë të drejtë.

Përgjegjës i Sektorit të Pyje-Kullota; Klarsen Brako:Përshëndetje, mbase nuk është paraqitur me fshatra, po neve sipërfaqen e fondit pyjor, atë që kemi me rakti, ne e kemi me ekonomi pyjore, kështu që. Kjo sipërafqe që ti thua është e përfshirë në ekonominë pyjore Maliq-Lozhan, edhe është e gjithë sipërafqja.Masat janë marrë me ekonomi pyjore dhe ekonomia. Pyore fillon nga Maliqi deri në Lozhan. Kështu që, pavarësisht se sa është përmendur, nuk ka një administrator ku ne do të bëjmë takimet për masat e zjarreve.

Kryetari i Bashkisë;z.Gëzim Topçiu: Megjithatë materiali duhet të rishikuar. Të shkruhet që janë shtatë njësi administrative. Dhe pavarësisht se plani i menaxhimit dhe i parandalimit të zjarreve bëhet sipas planeve, sipas zonave që ju kini të menaxhimit pyjeve. Edhe kullotave, ky është një gjë tjetër, por informacioni duhet të jetë i plotë dhe ke shumë të drejtë në atë shqetësim që ke.

Faslli Zholi: Unë desha shtoja dhe të pyesja shumë mirë bëhet dhe dua ta falenderoj Bashkinë e Maliqit me zjarrëfikëset e me këto për kanalin e zjarreve që e kemi parë dhe ka ecur mirë dhe nuk janë kursyer ata djemtë e zjarrfikses. Kjo është gjë pozitive për ne dhe mjetet e tëra ato. Jemi më mirë të themi se ë dikush tjetër. Një pyetje kam unë këtu për menaxhimin e zjarrit, po si i bëhet përdëmtimin e pyjeve në mënyrë të paligjshme? I vazhdon e vazhdojnë, që s'ka mbetur gjë hiç deri tashi. Sepse ne dimë që ngrohemi me zjarr, po unë mendoj këtu që ç'herë mund të bëjmë, si mund t'organizohet që kjo punë të mos, ku mund t'mbjellim një pemë, ku ku mund mbjelli një diçka dhe të mos i lëmë, se shikojmë çunat. A më kalon dot një makinë? Këtij i shikoj, mezi bëj ca dru. Bëhuni i zotë, e kam fjalën të bëhemi zoti, të mos presim filizat e reja. Se pashë që në bofje, e pash që andej këtej, se i dimë, njohim zonat. Dhe shumë mirë u bë qoftë edhe ato fshatra që kanë pyje, që e ngriti dhe këshilltari aty i nderuar, edhe ajo të shënohet, po që kjo mua më shqetëson më shumë prerja në mënyrë të paligjshme, në mënyrë barbare, që e ka nxjerrë Shqipërinë, mos them edhe bashkinë tonë, zero.

Përgjegjës i Sektorit të Pyje-Kullota; Klarsen Brako:E para, po ta shikosh, ky është plani i masave që bëhet për sektorin e pyjeve, jo për zjarrëfikësen, sepse zjarrfikësja ka një plan masash më vete. E dyta. Vetëm këtë muaj janë katër rastet që janë shpënë prokurori për transport të paligjshëm të pyjeve. Kështu që inspektoriati ka bërë punën e tij. Edhe e treta nuk ka qenë ndonjëherë bashkia Maliq, i gjithë ky territor më mirë se kaq, që të jetë ulur prerja e druve, prerje e pyjeve të paligjshme. Nuk ka qenë ndonjëherë më mirëse kaq. Sepse po të vihen për këto fshatrat para disa vitesh. Gjeje dru të stivosur në anë të rrugës. Sot po të vesh, të siguroj që ose hajde të vemi të dy, po t'gjejmë dru. Ose makina që lëvizin me material paligjshëm.

Faslli Zholi:I nderuar Klarsen do të them një gjë, unë e di që thua ti, edhe unë i shikoj, edhe tii i shikon, edhe gjithë secili e di. Por unë dua të shtroj pyetjen në letër, këta që merren me prej dru e shesin dru. A ka një licencë? Dhe a e dini, a e kam, ta di edhe unë, se mbase kënde jam gabim. Nuk e di, sepse neve lamë policinë ca kohë në tylbe Goçës. Ata s'bënin gjë tjetër, mund të ruani diçka tjetre, po ruani vetëm ata dru kalonin dhe bëheshin ato tashi. Jemi, mos e themi këtë, sepse po të shikosh hyrë në Maqedoni, se pardje isha unë, pse vajta mora naftë me makinët hyre këtej, ndryshon puna. Këtë ta pranojmë të gjithë që neve kemi futur duart barbarisht. E kam këtë që t'ë mundohemi të bëjmë më t mirën se. Dhe unë, për shembull, pyjet i dua, sepse janë mushkëri. Kur themi i dua. I do ajo, është sistemi ekologjik. Për sa më tepër zjarrfikset, e thashë, e pashë planin. Ësht plani i masës. Për të mbrojtur nga zjarret, jam plotësisht dakord me atë. Po desha të thosha që zjarrëfikset kanë bërë atë punë që unë i shikoj. Ju ka rënë zjarri këtu e këtë. Ata kanë qenë korrekt dhe janë për falënderuar. Dhe kam thën që në fillim, që kur ka kam ardhur këtu që një punë që është mirë e shikojmë mir, do t'ia themi, le të jetë kushdo këtë të kemi përpara. Unë pë

këta kam ardhur edhe sot, sepse do flas sikur poshtë në emër, se nuk kanë ardhur në këshilltarve e opozitës, sepse ata kanë dhe të drejtë që do t'i citoj dhe ato gjëra po kanë dhe gabime, edhe unë kam gabime. Po unë këtu nuk të vij si faleminderit.

Kryetari i Bashkisë;z.Gëzim Topçiu:Në fakt, ka një përmirësim në lidhje me prerjen e druve të zjarrit. Dhe kjo ka disa arsye, patjetër, është bërë një punë shumë e mirë, dhe nga policia e rendit, patje edhe në inspektorët e Mjedisit apo inspektorët tonë në terren, po prapë lë vend për t'u riparë. Lë vend se ajo çfarë duhet bërë është parandalimi. Nuk na intereson, po u pre druri, çohe të ditën. Edhe pse ajo ka efektet e saj në ndalimin, uljen e prerjeve të tjera, por në fund të fundit shërbimi pyjor duhet të jetë patjetër më. më i pranishëm terren për të ndaluar çdo lloj prerjeje dhe ndoshta edhe ky plan masash. Për mua, ndoshta duhet të jetë më i detajuar. Se vërtetë thuhet miratimi i planit ka një relacion, ndoshta duhet të ketë një plan me hapa me të tjera, të cilat, që nga takimet me barinjtë, qoftë në takimet me kryetarët e fshatrave, çdo gjë që ka të bëjë me këtë punë, edhe me afate të dedikuara dhe me punën konkretisht. Rimbjelljet, atë shqetësim që ngriti.

Përgjegjës i Sektorit të Pyje-Kullota; Klarsen Brako:Ky është një plan standard që ne na vjen nga Ministria.

Kryetari i Bashkisë;z.Gëzim Topçiu: Ne ta zhvillojmë pavarësisht standard, standard na i bëjmë që të jemi sa më afër realitetit tonë, kështu që prandaj sugjerimi duhet parë e duhet plotësuar. Shumë faleminderit.

Ornildi Demollari:Të lutem, kemi gjë tjetër? E kalojmë në votim, atëherë kush është dakord? 17 vota pro.
Kundër? Nuk ka.
Abstenim? Nuk ka. Miratohet me shtatëmbëdhjetë vota. Faleminderit. Kalojmë tek pika tetë e rendit të ditës. Më falni, tek pika nëntë e rendit të ditës, projekt vendim për miratimin e listës së kullotave dhe kositjeve për vitin 2026 dhe miratimi i kontratës tip të dhënies me qera për kullotë, kush e do fjalën?

Përgjegjës i Sektorit të Pyje-Kullota; Klarsen Brako:Kjo është një procedurë që neve duam të njohim këshillin edhe me kontratën të tij. Këtë e kemi në radhë të parë, e kem detyrim ligjor që ta kalojmë në këshill, e dyta është që t'a njohim , t'ia njoftojmë edhe këshillin se si e lidhim ne kontratat. Pastaj lidhja vazhdimi më tej ka procedura të tjera, sepse neve jo çdo qytetar që mund të vijë të bëjë kërkesë mund ta lidhin direkt kontratën. Ka edhe ajo kërkese të saj. Procedura. Më vete që lidhet kontrata, jo gjithë ato listë që ka dalë aty. Është e thënë që ne do t'i japim me ku për kullotje. Se shumë prej atyre janë larg, edhe shumë njerëz nuk i marrin kështu që ne thjesht e kemi si procedurë ligjore që ne të kalojmë gjithë listën, ç'a kullota kemi.

Ornildi Demollari: Kryetar, kështu gjë tek kjo?

Kryetari i Bashkisë;z.Gëzim Topçiu: Jo, është një procedurë.

Faslli Zholi: Kam një gjë këtu, shumë mirë. Me kjo e kontratëve, se neve na bën mirë puna me kontratat, neve duhet të luftojmë që sa më shumë blegtorë ata që kanë mbetur, edhe t'i stimulojmë. Që ta marrin me kontrata dhe të japin edhe dy leka këtum pse jo bashkisë, kjo do të jetë gjë e mirë, mendoj.

Ornildi Demollari:E kalojmë votim, atëherë kush është dakord? 17 vota pro.
Kundër? Nuk ka.
Abstenim? Nuk ka.Me shtatëmbëdhjetë vota pro, miratohet faleminderit dhe kalojmë tek pika e fundit e rendit të ditës, që është projektvendim për identifikimin e pasurisë në fshatin Leminot, njësi administrative Pirg.I cili është hartuar bazuar mbi një kërkesë që banorët e fshatit Leminot kanë drejtuar këshillit dhe bashkisë dhe është përgatitur sot materiali e ka erdhur sot për këshillin. Me vonesë, po besoj, ju ka erdhur.Mund të na shpjegosh, kryetar, diçka?

Kryetari i Bashkisë;z.Gëzim Topçiu: Po, është një segment i cili figuron në regjistrat kadastral, me shenjën X të themi, po e paprecizuar është rruga, po është kanal, apo është? Është evidentuar nga pas kërkesave që kanë bërë vetë banorët e kësaj. I fshatit Leminot, nevojave që ata të kenë, pasi në qoftë se do të ndërtosh diçka në zonën tënde, një magazinë, në një aktivitet ekonomik në tokat, të cilat janë në këtë zonë, ata i ndalon për të dalë direkt në rrugën nacionale, pasi duhet të ketë një rruge dytësore që ai ta zhvillojë si pronë. Ndaj, edhe ata kanë parë të arsyeshme të na i sjellin kjo do një vendimarrje të Këshillit të Bashkisë që ne t'ia prezantojmë, Kadastrës në Korçë, që kadastra të ketë mundësi t'i vendosë një numër kadastral nga iks, e cila nuk e përcakton çfarë është, e përcakton rrugë dhe atyre u shërben për aktivitetin e tyre. Kaq është e thjeshtë, nuk ka lidhje me ne.
Ornildi Demollari:Është e qartë, ka ndonjë e kalojmë në votim. Atëherë, kush është dakord? 17 vota pro.
Kundër? Nuk ka.
Abstenim? Nuk ka, miratohet me shtatëmbëdhjetë vota pro. Faleminderit. Kishim dhe një material tjetër që është rregullorja për titujt e nderit, por nuk e kishim në rendin e ditës dhe as nuk e shtuan rendin e ditës dhe mendoj që do ta kalojmë për mbledhjet e ardhshme. Për arsye që këshilltarët të fitojnë dhe me shumë kohë po.

Kryetari i Bashkisë;z.Gëzim Topçiu: Ky moment pauzë le të shërbejë le e të themi nga kjo mbledhje në një mbledhje të radhës, le të shërbejë për anëtarët e këshillit të bashkisë, që mund të sjellin apo për grupet, që mund sjellë ndonjë propozim, ndërkohë që ne ta përfshijmë në rregull. Ne jemi munduar ta jemi. Pjesë e ligjit, edhe e cili përcakton mënyrën se si duhet të jetë ky kjo rregullore apo ai komisioni këshillimor pranë këshillit të bashkisë, me qëllim që gjithë procedurat standarde të mos lehen jo vonesa, jo mbetje poshtë e lartë të propozimeve të tjera.

Ornildi Demollari: Faleminderit dhe jemi tek pika të ndryshme, në qoftë se kemi një gjë, po.
Faslli Zholi: Edhe një herë ju falenderoj, i nderuar kryetar dhe kryetari i këshillit. Meqënëse jemi

këtu sot, unë nuk kam erdhur si zë i vetëm në këtë sallë të opozitës, sepse kolegët këshilltarë të opzozitës kanë disa gjëra që unë, prandaj erdha që t'i bëj publike, se unë i kam qejf gjërat ti bëj në shesh edhe nëpër letra, se letrat në fund janë kryesoret. Ata kishin hedhur në email. Unë as edhe email-in nuk e përdor dot mirë dhe nuk i kisha parë. Sot e pashë edhe atë projektvendimin që porsa thamë për së i përket titujve dhe stimulimit, dua të sqaroj disa gjëra. Dëgjoni me kujdes, sepse unë nuk dua që unë kam ardhur këtu, se edhe si Këshilltar kam hyrë nga subjekti politik, po pastaj i referohem gjithmonë halleve dhe problemeve të këtij komuniteti. Kur them unë dhe shumë shokët e mi e kolegët të mi, po dikush mund ta mendojë se erdha këtu edhe ska nuk më kanë thënë qytetarët e bashkisë së Maliqit, kur mora votën që është kohë. Këshilltar dhe pastaj rri në shtëpi. Unë do vij këtu dhe do them këtë ato që janë. I mendoj këtu në sallë, së bashku me ekzekutivin, s'ë bashkë me gjithë ju. Tani çfarë duhet të thosha? Në debatet e kolegëve të mi, edhe unë së pashku me ta, kanë degjeneruar, deri në këtë pikë që sot mua më bëhen një thirrje kolegët e këshillit që të mos vinja ta bojkotoja sallën. Arsyeja është sepse unë kur mbetem mbledhën e kryesisë dhe marrim vendime dhe pranojmë ato që miratuam. Unë do të vij në mbledhje, kur vete nën mbledhen e komisioneve. Shikoj dhe them ato ç'duhet të them. Un do t'vij këtu dhe t'i miratoj, sepse qytetarët nuk kanë asnjë të keqe ose asnjë detyrim që se çfarë kam unë me iksin apo me y. Ku ka filluar ajo që këtu keni përgjegjësi? Juve si mazhorancë ndaj nesh dhe cilat janë, unë i kam bërë hera herës edhe këtu prezent. E para, shumë gjëra që kemi kërkuar si opozitë, përveç se një herë mbaj mend unë që na keni futur në renditë dhe që bëmë nj'mbledhje për sa i pëket ngricave. E bëjmë atë mbledhjen, u tha do bëjnë këto, do breni këta që edhe sot. Ata qytetarë që ashtu nuk kanë marrë asnjë lloj shpërblimi. Këtë e mbaj mend unë, mbase jam gabim nga ana tjetër. Kërkuam me të bërë zgjedhjet që të shkonim sipas rregullores, sepse këtu ata kërkojnë, dhe unë kërkoj së bashku me ata që kemi shkelje. të asaj që kemi vendosur të ligjit, si është? Për shembull, ligji nuk e ka bërë, dhe rregullorët e këtij këshilli nuk ka bllokuar kjo lista. Po jemi detyruar për sa është në fuqi, ne do ta zbatojmë. Ne kemi dalë në konteksi i kësaj dhe ku kemi dalë së pari, kur bëmë pushtetin vend ato zgjedhjet e kryepleqësisë. I bëjmë ashtu si i bëmi edhe duke e shkelur ligjin, sepse rregullorja nuk thoshte ashtë. Për këta jemi koshjent të gjithë, bëmë mbetën fshatrat, të cilët neve kërkojmë herë pas here. Nuk është qëllimi as i Zvezdës, as i Dirthas, por ë një detyrim ligjor. Ne kemi dalë në këtë kontekst, për shembull. Po flas konkretisht me Zvezdën. M'u tha në kryesi një radhë që i kemi bërë, dhe sekretari është këtu. I kërkova. Dhe sot nuk po marrim përgjigje. Kërkove atje, janë koshientë këtu edhe kryetari që s'ishim në kryesi, më sillni procedurat që janë zhvilluar zgjedhjet e Zvezdë. Me juristin me ato ma sillni dhe është e mbyllur kjo punë, pse të bëhemi neve tashi? Kjo mua më shqetëson e para. Kur them për zvezën, ne kemi një tjetër vacant, ndjes pastë, ajo që ka vdekur atje, ne duhet ta kishim bërë edhe këtë rregullim, shkojmë në Drithas, as na dhatë përgjigjen që do bëj kështu. Po ta kishim sistemuar në qoftë se neve derisa bën zgjedhje dhe atje mund ta kshim vënë një kryeplakë. Nuk është ndonjë e madhe se të kemi nj'kryeplaku aty në atë komunitet. Se derisa aty ka qendër votimi, të ketë dhe kryeplaku. Tjetër gjë që unë do të thoshja, ne kërkuam mbledhjen e dymbëdhjetë të marsit. E miratuam bashkërisht këtu, të bënim një mbledhje speciale me administratorët, me kryepleqtë dhe me të dëmtuarit. Pse u dëmtuan? Pjesa më e madhe qytetar këtë e dinë. Edhe disa zëra që qenë atë ditë këtu edhe diskutohen, kanë heshtur sot, heshtja është problemi i tyre pa i hyrë detajeve. Por do të them një gjë, mua m'u tha atë ditë, ditën e dytë, edhe

në kryesi, që ju kishit thirrur njerëzit sikur do t'u jepnin leka. Ne nuk u dhamë leka njerëzve dhe s'po i japim dot as sot, as jo as neve, këtyre që ishin fakirët e përmbytjeve. Prandaj, pësa i pëket kësaj materialit, paraprakisht unë mirë që e tha. Edhe vetë unë, edhe sikur të votojnë, do votoj nja kundër. Po do kërkoj që të kemi kohë më shumë, që këshilltarët edhe të opozitës edhe ju, se kemi folur për bashkëpunim. Kemi folur frymë, kemi për qytetarët, jo të bëjmë për subjektet politike, por për individët personale, sepse unë po e them edhe këtë. Vetë si person karakterizohem nga tre gjëra, nga ndërshmëria, drejtësia dhe sinqeriteti. Dhe nuk ka perëndi as në këshillin e grupit tim të më thotë ktej apo këtej, as dikush edhe secili varet edhe ka kokën mbi vete. Unë kjo nuk jam, por këto janë e drejta opozitës që i ka kërkuar këtë gjëra. Ju keni edhe kartonet, por ne kur bëjmë kërkesat, të paktën të merren e të shtrohen këto. Të futen në rend dite, kur këërkoj një gjë, t'i futen rend dite. Pastaj kartonat është tjetër gjë se si e bëjnë, sepse unë kam qenë dhe do të jem bashkëpunues i kësaj bashkie derisa të mbaroj mandatin, që të punoj dhe të bëj aq sa mundem. Po unë kam qëndruar korrekt.Edhën dëgjesat, prandaj këshilltarët e mi. Ia kam thënë, do t'ia them edhe në grup. Kanë dhe këtë, sepse debatohen që ke dhe me Verën dhe më të zonjën që është këtu. Apo iku? Përsa i përket dekurimeve, ne kërkuam disa herë dekurimet. Pyetja shtrohet a. A bëmë ne gabim ata dekorimet që bëhemi një ditë këtu, që u bë shumë bukur, dhe sollëm tre kandidatura të shkëlqyera për komunitetin e Maliqit, q kanë çfarë të mësojnë fëmijët nëpër shkolla, të tre me famë, qoftë Demollari, qoftë profesori Aliu, qoftë edhe Gjergji. Kjo ishte një gjë pozitive. Do të themi diçka tjetër, ne jemi bashkë këtu dhe nuk do të kthehemi. Këta kështu e këta, kur u bënte dekorimet kanë pakënaqësira opozita. Ne ishim firmëtarët e kësaj gjashtëmbëdhjetë. Ju e bëtë shumë mirë këtu, nuk u ngarkoj me faj. E hodhët. Në sistem që do të mblidhemi në datën 25, pasi u bë data 24. Bukur, siç erdha unë, të vijnë edhe ata. Kjo është përgjegjësi e tyre. Po, cila është organizimi? Duhet ta kishim diskutuar edhe në kryesi. Organizimit tonë u bë deri këtu që e bëri bashkia prefekte, se isha këto e ndoqa. Më tej tashti, edhe dreka nuk është problemi, as pasi s'ka ngelur pa ngrënë. Mua m'u tha, po e them shqip në iks, këshilltar që ja u kanë lënë, jo do ta them. Ja u kan lë, ja u ka lë tre personave. Ja, u kam lë në tre persona që do t'u ashtu, i thashë jo. Dhe ndaj nuk vajta në atë drekën, sepse ishte, duhet të ishte. Jo, kjo ka një rëndësi të veçantë për këshilltarët.

Ornildi Demollari: Faleminderit, e mbyllim këtë pjesë.Kjo ishte mbledhja.Faleminderit!

Mbajtës Protokolli

SEKRETARI I KËSHILLIT

Gertjan GJIRITI

KRYETARI I KËSHILLIT

Ornildi DEMOLLARI